



REPUBLIKA E SHQIPERISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË
SENATI AKADEMIK

Nr. Prot.

Vlorë, më 06.09.2016

Vendim
Nr. 32, datë 06.09.2016

**PËR FILLIMIN E PROCESIT TË RIORGANIZIMIT AKADEMIK DHE
ADMINISTRATIV TË INSTITUCIONIT
DHE HARTIMIN E STRUKTURËS SË PËRGJITHSHME TË TIJ**

Në mbështetje dhe në zbatim të pikës 5 të nenit 25, pikës c të nenit 129, të pikës ç të nenit 38, të ligjit Nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", të ligjit nr. 90/2012, "Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore", si dhe në zbatim të VKM Nr. 893, datë 17.12.2014, "Miratimi i rregullave të organizimit dhe të funksionimit të kabineteve ndihmëse, të organizimit të brendshëm të institucioneve të administratës shtetërore, si dhe për procedurat e hollësishme për përgatitjen, propozimin, konsultimin dhe miratimin e organizimit të brendshëm", Senati Akademik i Universitetit "Ismael Qemali", Vlorë, në mbledhjen e datës 06.09.2016

VENDOSI:

1. Riorganizimin e brendshëm akademik dhe administrativ të institucionit në përputhje me kërkesat e ligjit Nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë" dhe akteve nëligjore të pritshme në zbatim të nenit 129 të këtij ligji. Ky riorganizim të përfshijë:

- a) Riorganizimin akademik dhe administrativ në funksion të hartimit të strukturës së përgjithshme, organikës dhe numrit të personelit në të gjitha nivelet e institucionit, konform përcaktimeve ligjore të *Organizimit akademik* (neni 36 i ligjit) dhe *administrativ* (neni 47) të IAL-ve si dhe përcaktimeve të personelit *akademik*, personelit *ndihmësakademik* (me karakter mësimor dhe administrativ) dhe personelit *administrativ*, (nenet 66 e 67).



REPUBLIKA E SHQIPERISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË
SENATI AKADEMIK

- b) Organizimin e departamenteve në *grupe mësimore* dhe në *grupe* (të përhershme ose të përkohshme) *me karakter kërkimor-shkencor*, (neni **25**),
 - c) Çeljen dhe funksionimin e qendrave kërkimore-shkencore (sipas nenit **26** të ligjit) në FSHH, FE, FSHP si dhe riorganizimin e qendrës ekzistuese kërkimore-shkencore në FSHT konform kuadrin ligjor në fuqi, sipas propozimeve të organeve dhe autoriteteve drejtuese përkatëse dhe miratimin e personelit për to.
 - d) Miratimin në strukturën e Fakulteteve të numrit të zv/Dekanëve nga 1 në 2 apo 3 (sipas propozimeve argumentuese), (neni **43**).
 - e) Miratimin në strukturën e Rektoratit të numrit të zv/Rektorëve nga 1 në 2 apo 3 (sipas propozimeve argumentuese), (neni **40**).
 - f) Miratimin e pozicionit të punës Sekretar Dekani në fakultet, etj.
2. Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi: Rektori, Rektorati, Zv.Rektori, Kancelari, Dekanët, Përgjegjësit e departamenteve, Drejtoria e Financës dhe Zyra juridike.
 3. Vendimi protokollohet dhe bëhen njoftimet përkatëse.
 4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I SENATIT AKADEMIK
Prof. Dr. Roland ZISI

Ky dokument përpilohet në 3 (tri) kopje.